



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

02 Nr. 1154

Datë 05/11/2024

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të nenit 40, të Ligjit Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë dhe në bazë të nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për procedurat e pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës së Shtimes merr:

**V E N D I M**

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL  
Grupi i shkencave shoqërore-Zyrtar për Shërbim me Qytetarë, RN00015362 , RPC0008901

I. Formohet Komisioni për pranim në shërbimin civil të komunës së Shtimes në përbërje:

1. Naim Hasani (Udhëheqës i Njesisë për Menxhimin e Burimeve Njerzore) -Kryesues Komisionit
2. Skender Dauti- (Udhëheqës i Sektorit për Emergjencë)-Antarë
3. Sami Januzi (Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit )-Anëtar
4. Idajet Rexhepi ( Udhëheqës i Sektorit për Administratë të Përgjithshme)-Anëtar
5. Minire Halili ( Zyrtar i Lartë për çertifikim )-Anëtar

Anëtarët e Komisionit Zëvendësues:

1. Ardita Ndrecaj - (Zyrtar i Lartë për Personel)
2. Muhadin Halili - ( Udhëheqës i Zyres së Prokurimit)-Antarë
3. Ejup Ismajli - (Udhëheqës për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim Rural) - Anëtar
4. Kimete Ukaj ( Udhëheqëse për Buxhet)-Anëtar
5. Kaltrina Beqa — (Zyrtar për Personel) Anëtar

II. Komisioni i vlerësimit për Pranim në Shërbimin Civil fillon punën gjatë fazës së përgaditjes për testim me shkrim i cili mbahet në formë elektronike vlerësimin e jetëshkrimit/CV-së dhe intervistimin e kandidatëve të paraqitur.

III. Komisioni i vlerësimit për Pranim në Shërbimin Civil ka për detyrë dhe është përgjegjës që të bëjë vlerësimin e kandidatëve dhe të nxjerrë listën me kandidatët fitues në përfundim të vlerësimit për kandidatin më të suksesshëm.

IV. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nëshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Iu dërgohet:  
Anëtarëve të  
Komisionit  
Arkivit

